



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1546/ 5 prot.

Datë 11.07.2024

**V E N D I M**

**Nr. 857/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.07. 2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-07760-06-03-2024, me objekt: **“Loti i dytë: “Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group SHA dhe bijave” me vlerë fondi limit 22,729,430 (njëzet e dy milion e shtatëqind njëzet e nëntë mijë e katërqind tridhjetë) lekë pa TVSH ose 225,356.2 (dyqind e njëzet e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë dy) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 04.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group SHA.**

Vendim për mbylljen e çështjes, për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit të mësipërme.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të mësipërme.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK me NIPT L52122014L dhe adresë ish blloku i magazinave të tregtisë, Rruga “Siri Kodra”, Tiranë.

Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë Kodër - Kashar, autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Tiranë .

**Autoriteti Kontraktor:**

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group SHA me adresë Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia administrative nr. 7, 1023, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje

me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 04.06.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-07760-06-03-2024, me objekt: **“Loti i dytë: ‘Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group SHA dhe bijave’”** me vlerë fondi limit **22,729,430 (njëzet e dy milion e shtatëqind njëzet e nëntë mijë e katërqind tridhjetë)** lekë pa TVSH ose 225,356.2 (dyqind e njëzet e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë dy) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 04.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group SHA.

II.2. Në datën 11.06.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4198, protokolluar me nr. 1546/2024 prot., datë 11.06.2024, i operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.2.1. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.3. Në datën 13.06.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4216, protokolluar me nr. 1589/2024 prot., datë 14.06.2024, i operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3.1. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Me anë të shkresës nr. 4157/10 prot., datë 18.06.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1546/2 prot., datë 18.06.2024, me lëndë “Kthim - përgjigje”, drejtuar operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka përcjellë aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, nga ku rezulton se ka pranuar ankesën si vijon:

*1-Për sa i përket pikës së parë të ankimit të paraqitur nga OE cit\**

*“[...] KSHA në shqyrtim të ankesës sqaron se:*

*-Është kërkuar makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me përmasa më të mëdha për vetë faktin që kjo makinë shtypi nevojitet për prodhimin e artikujve të renditur në preventivë 1-4 të cilët sipas specifikimeve teknike kërkohen të shtypen me logon e OSHEE Group të shtypur me 5 C( 4C + ngjyre special pantone orange 021 C ose ekuivalente) + llak. Nisur nga kjo specifikë autoriteti kontraktor legjitimohet të kërkojë në përputhje me parashikimet e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik **për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.***

***Megjithatë kriteret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.***

*Nga ana jonë vlerësohet që kriteri i vendosur për makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me përmasa më të mëdha është në përputhje me specifikimet teknike dhe me artikujt të cilët janë parashikuar të furnizohen nëpërmjet kësaj kontrate.*

***Referuar nenit 21 “autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.***

*Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

***Marr shkas nga pretendimi i ngritur nga ankimuesi që prodhimi i mallrave që kërkohen të furnizohen nëpërmjet kësaj kontrate mund të realizohen teknikisht edhe nëpërmjet 1 (një) makinerie/pajisje shtypi “Makinë shtypi 50x70 4 C + llak, pavarsisht metodologjisë apo***

**teknikës së përdorur, vlerësojmë që Për sa kohë qëllimi final i autoritetit kontraktor është të vërtetojë nëse subjektet ofertues zotërojnë ose jo kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës, duke pranuar kërkesa për për “makinë shtypi 50x70 4 C + llak”**

**Për sa shpjeguar më lart pretendimi i ankuesit qëndron.**

2-Për sa i përket pikës së dytë të ankimit të paraqitur nga OE për të cilën pretendohet se, cit\*:

“[...]Në ankesë ngrihet pretendimi se:

Nisur nga fakti që në specifikimet teknike të përcaktuara në DST të artikujve/ produkteve që kërkohet të paraqiten mostra/modele nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, nuk përcaktohet asnjë marzh dhe tolerancë +/- në gramaturë.

Duke marrë gjithashtu në konsideratë që Komisioni i Prokurimit Publik me antë të disa vendimeve të tij ka skualifikuar operatorë ekonomikë pjesëmarrës pasi mostrat e dorëzuara prej tyre kishin një diferencë në peshë minimale më të vogël, apo më të madhe se ajo e përcaktuar në DST.

...por ka patur edhe rate gjithashtu që Komisioni i Prokurimit Publik me anë të disa vendimeve, ka konsideruar të rregullt ofertat e disa operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, pavarësisht faktit se peshat e letres dhe/ose kartonit nuk ishte ekzaktesisht sa ajo e kërkuar dhe përcaktuar në DST.

...për të eliminuar/ shmangur cdo lloj vendimarrje diskrecionale dhe të pambështetur në kritere teknike (në të 2 rastet e lartëpërmendur) nga ana e AK dhe KPP mbi këtë kriter të përcaktuar në DST.

kerkojme të përcaktohet edhe marzhi dhe toleranca +/- në gramaturë, Për sa i përket peshës së letres dhe kartonit të mostrave të kërkuara në DST, si dhe nëse ekziston një tolerance e tillë, cila/cfare tolerance +/- është e pranueshme nga AK...

Per sa mesipër, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, ky kriter teknik lë vend për vendimarrje diskrecionale dhe të pambështetur në kritere objektive dhe teknike nga ana e AK dhe KPP, dhe për këtë arsye shtojca 5 "Formulari i Specifikimeve

teknike", të Dokumentave Standarte të Tenderit të t'atë të ndryshohet, duke përcaktuar dhe saktësuar marzhin dhe tolerancën +/- në gramaturë, Për sa i përket peshës së letres ane kartonit të mostrave të kërkuara në DST. Hartimi i specifikimeve teknike është mbështetur në vendimin nr. 1 të KLA datë 18.01.2023..."

KSHA në shqyrtimin e Ankesës lidhur me këtë shqyrtim të ngritur argumenton se është parashikuar marzhi apo toleranca +/- në gramaturë. Duke qenë se nuk ekziston një standart kombëtar apo ndërkombëtar ku të mbështesni kërkesën tuaj për të parashikuar marzhi apo toleranca +/- në gramaturë, vlerësojmë se nuk është mbështetur kërkesa juaj dhe si e tillë nuk mund të pranohet.

*Për sa shpjeguar me lart pretendimi i ankuesit per marzh apo tolerance +/- në gramaturë nuk qendron.*

*Theksojme se duke marre ne kosiderate shqetesimin e ngritur lidhur me testimin e mostrave dhe rezultatet e perftuara, mendojme se duke qene se mostrat e kerkuara zene nje peshe specifike minimale ne raport me te gjithë zerat e tjere, per te shmangur problematikat ne vleresim dhe per te eliminuar ne maksimum kontestimet konkudojme se per nje vleresim sa me objektiv dhe te barabart per te gjithë operatoret kriteri per paraqitjen e mostrave te hiqet.*

II. 5 Me anë të shkresës së ardhur nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me nr. 1589/2 prot., datë 21.06.2024, me lëndë “Shqyrtim ankese”, drejtuar operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka përcjellë aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, nga ku rezulton, se ka pranuar pjesërisht si vijon:

*Për sa i përket pikës së parë të ankimit të paraqitur nga OE cit:*

*KSHA në shqyrtim të ankesës sqaron se:*

*OSHEE Group sh.a është ent kontraktor i cili prokuron mallra, pune dhe shërbime me fondet e veta, te cilat miratohen çdo vit nga Keshilli Mbiqyres dhe Asambleja.*

*Buxheti per vitin 2024 është miratuar ne 12 prill 2024, ndaj ne keto kushte ka qene e pamundur te permbushen kerkesat e VKM 360 date 26.04.2017 ndryshuar me VKM 331 date 22.05.2019 dhe VKM 608 date 22.09.2022, neni 4/1, pika 3 ku shprehet se cit brenda dates 1 mars autoritetet ose entet kontraktor i dergojne Drejtorise se Pergjithshme te Arkivave, specifikimet teknike, kerkesat sasimore dhe fondin limit. Kerkesat e derguar pas kesaj date muk do te merren parasysh per prokurim per vitin pasardhes.*

*Ne kushtet kur OSHEE Group sh.a nuk kishte buxhet te miratuar ishte e pamundur te permbushej kerkesa e nenit 4/1 pika 3, pasi nuk mund te perllogaritej fond limit pa ze te buxhetuar.*

*Sjellim ne vemendje se me VKM 608 date 22.09.2022 neni 4 shkronjat "T" dhe "II" dhe shkronja "m" jane shfuqizuar dhe është shtuar neni 4/1 me permbajtje si vijon:*

*Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen blerjen e përqendruar për të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për furnizimin me kuti dhe dosje të standardit të përhershëm, përfshirë edhe etiketat e tyre. Procedura e prokurimit kryhet çdo vit për vitin pasardhës, duke marrë parasysh në këtë procedure edhe shtrirjen gjeografike të vendruajtjes depozituese finale të dokumentacionit arkivor, për të cilin kryhet blerja e përqendruar.*

2. Brenda datës 1 shkurt të çdo viti, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave njofton përmes rruges shkresore dhe /ose elektronike autoritetet dhe entet kontraktore për:

- a) standardet kombëtare të miratuara për kutitë dhe dosjet e standardit të përhershëm;
- b) çmimin për njësi të llogaritur përmes parashikimeve ligjore, e indeksuar me ndryshimet e mundshme të evidentuara gjatë studimit paraprak të tregut, të kryer prej saj.

3. Brenda datës 1 mars, autoritetet ose entet kontraktore i dërgojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave specifikimet teknike, kërkesat sasiore dhe fondin limit. Kërkesat e dërguara pas kësaj date nuk merren parasysh për prokurimin për vitin pasardhës.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen procedurën e prokurimit nga procesi i njoftimit të kontrates deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuader. sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

5. Per çdo kontrate të lidhur nga autoritetet dhe entet kontraktore, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen verifikimin paraprak të cilësisë Për sa i përket jetëgjatësisë së kutive dhe dosjere standardit të përhershëm, sipas udhëzimeve administrative të saj. Autoritetet ose entet kontraktore marrin në dorëzim kutitë dhe dosjet bashkë me dokumentacionin shoqëruar të verifikimit paraprak të cilësisë.”

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

**Duke qene se neni 4/1 nuk ndalon krverien e procedurave te prokurimit nga entet kontraktore qe prokurojne materiale arkive per ruajtje jo te perhershme vleresojme se parashtrimi juaj dhe analiza e bere lidhur me kete ceshtje nuk qendron, ndaj rrjedhimisht nuk mund te merret parasysh kerkesa per anullimin e kesaj procedure.**

**Për sa shpjeguar me lart pretendimi i ankuesit nuk qëndron.**

**2-Për sa i përket pikës së dytë të ankimit të paraqitur nga OE cit\*;**

Per te gjithë artikujt e perfshire ne kete procedure prokurimi, parametrat jane fikse dhe nuk eshte vendosur asnje marzh ne plus apo minus ne raport me parametrat e vendosuar per artikujt nga AK-ja, pra kufijte brenda te cilave lejohen plus dhe minus, Për sa i përket parametrave te permasave dhe te peshes. Ne lidhje me hartimin e specifikimeve teknike te artikjve objekt i ketij prokurimi nga AK-ja ne procesverbalin e hartimit te dokumentave nuk eshte dhene asnje argument ne lidhje me hartimin e tyre. Nga autoriteti kontraktor ne procesverbalin e hartimit te dokumentave eshte percaktuar vetem fakti qe, specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e

vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor, por pa dhene asnje argument per operatoret ekonomike ne lidhje me arsyet e AK-se per percaktimin e ketyre parametrave fikse dhe pa lejuar asnje marzh me plus apo minus te ketyre paramtrave, brenda te cilave artikujt jane te pranueshem nga autoriteti kontraktor. Mos percaktimi per prametrat e permasave apo te peshes se kerkuar me marzhe te lejueshme, sjell kufizim te pjesmarrjes dhe orientim drejt artikujve te vecante pra, drejt prodhuesve te vecante. Kjo vjen ne kundfrshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik....

### ***KSHA ne shqyrtimin e Ankeses lidhur me kete pike argumenton:***

*Hartimi i specifikimeve teknike eshte mbeshtetur edhe ne vendimin nr. I te KLA date 18.01.2023, ne te cilin nuk eshte parashikuar marzh apo tolerance +/- në gramaturë. Duke qene se nuk ekziston nje standart kombetar apo nderkombetar ku ta mbeshtesni kerkesen tuaj per te parashikuar marzh apo tolerance +/- ne gramature, vleresojme se nuk eshte e mbeshtetur kerkesa juaj.*

*Po ashtu kerkesa juaj per percaktimin e nje marzhi te lejuar ne plus dhe ne minus prej 5% si Për sa i perket permasave ashtu edhe per sa i perket peshes se kerkuar nuk rezulton te jete e mbeshtetur ne ndonje specifike te miratuar nga organe kompetente apo nga standarte shteterore ne fuqi ndaj kjo kerkesa nuk mund te pranohet.*

*Por duke marre ne kosiderate shqetesimin e ngritur edhe nga ankesa e paraqitur nga subjekti Inpress sh.p.k lidhur me testimin e mostrave dhe rezultatet e perftuara, duke qene se mostrat e kerkuara zene nje peshe specifike minimale ne raport me te gjithë zerat e tjere, per te shmangur problematikat ne vleresim dhe per te eliminuar ne maksimum kontestimet eshte vendosur se per nje vleresim sa me objektiv dhe te barabarte kriteri per paraqitjen e mostrave te hiqet.*

***Për sa shpjeguar me lart pretendimi i ankuesit nuk qëndron.***

### ***3-Për sa i përket pikës së tretë të ankimit të paraqitur nga OE cit \*;***

*Kerkojme sakesime ne lidhje me produktet si me poshte:*

- 1. Per artikullin me numer rendor 3 (Dosje te shtypura me Format 50x70, permasa 33x25.5) me specifikimet teknike:me specifikimet teknike:*
- 2. Per artikullin me numer rendor 4 (Dosje te shtypura me Format 50x70, permasa 22x32),*
- 3. Per artikullin me numer rendor 19 (Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26) me specifikimet teknike:*



***KSHA ne shqyrtimin e Ankeses lidhur me kete pike sqaron:***

*Lidhur me konstatimet per piken 1 dhe 2 e gjen te drejte kerkesen tuaj dhe vendos ta pranoje me qellim saktessimin dhe percaktimin e sakte te formatit dhe permasave te dosjeve tek skicat.*

*Gjithashtu edhe per artikullin "Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26" e gjejme te drejte konstatimin dhe do te publikohet foto e sakte*

*-Për sa i përket pikës së katërt të ankimit të paraqitur nga OE cit \**

*-ne lotin e dyte jane perfshire gjithshu artikui te cilet iane shtypshkrime si artikujt me numral rendore si me poshte:*

*5 (Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve); 6 (Regjister dhenie- marrje dokumentash):*

*9 (Formular dorezim materialesh ne arkive); 10 (Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave):*

*11 (Fletehyrje e perkohshme ne arkive); 13 (Fletepalosje A4);*

*14 (Fletepalosje 20x21):*

*15 (Postera 40x58);*

*16 (Postera 50x70)*

*17(Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18);*

*18 (Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9); 19 (Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26).*

*Perfshirja e artikujve te mesiperm ne kete procedure prokurimi, nderkohe qe AK-ja shypshkrimet i ka percaktur ne lotin e pare te kesaj procedure vjen ne kundershtrim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik....*

***KSHA ne shqyrtimin e Ankeses lidhur me kete pike sqaron:***

*Ne lotin e dyte jane perfshire te gjitha artikujt qe lidhen ngushtesisht me proceduren e ruajtjes dhe arkivimit te dokumentacionit. Pra materialet jane grupuar ne lote te vecanta duke u nisur nga qellimi per te cilen blihen dhe nga funksioni qe kerkohet te kryejne. Pra ne lotin e dyte jane grumbulluar te gjitha artikujt te cilet lidhen ngushtesisht me procesin e arkivimit pra qe karakteristika te perbashketa dhe jane te nevojshme per te kryer procesin e arkivimit sic kerkohet nga specifikime. Te gjitha artikujt e listuar nga ana juaj i sherbejne ngushtesisht procesit te arkivimit te dokumentacionit dhe nuk mund te shkeputen dhe te trajtohen vecmas.*

*Te gjitha keto artikuj duhet te prodhohen sipas kerkesave dhe specifikime te vendosura nga autoriteti, pra keto artikuj do te jepen bruto dhe duhet te dizenjohen dhe pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim.*

*Sqarojme se te gjithë artikujve si dosje, kuti, etiketa, nuk mund te blihen te gatshme nga subjekte qe i tregetojne pasi ato duhet te prodhohen dhe realizohen nga operatori ekonomik ne perputhje me kerkesat specifikimet vetem pasi te dizenjohen dhe te miratohen nga OSHEE Group sh.a. Nuk kemi te bejme me blerje te produkteve te gatshme.*

***Për sa shpjeguar me lart pretendimi i ankuesit nuk qëndron.***

***5-Përsa i përket pikës së pestë të ankimit te paraqitur nga OE cit;***

- *ISO 16245 ose ekuivalent (per prodhimin e kutive dhe te materialeve te tjera, me celuloze, per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve) (e vlefshme, e akredituar nga DPA nga Organizma Nderkombetare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.*

***Se pari:*** *KSHA e gjen te mbeshtetur kerkesen tuaj per sa i perket ndryshimit qe duhet bere ne Formulimin qe: Operatori Ekonomik duhet te paraqese certifikata te vlefshme me objekt te njejte me objektin e prokurimit dhe ka vendosur ta pranoje kerkesen tuaj duhe e formuluar kete kerkese si vijon:*

***-Operatori Ekonomik duhet te paraqese certifikata te vlefshme objekti i te ciles perputhet me fushen e objektit te prokurimit.***

***Se dyti:*** *KSHA e gjen te paargumentuar kerkesen per heqjen e ISO 16245 ose ekuivalent pasi kjo iso verteton qe OE ofertues ne procesin e prodhimit respekton me rigorozitet dhe ploteson te gjitha masat e nevojshme per prodhimin e kutive dhe kapakeve te perbera nga material celuloze, te cilat perdoren per arkivimin e dokumenteve shkresore per nie periudhe te gjate kohe. Nuk eshte e vertete qe kemi te bejme me blerje malli te paster, pasi kemi te bejme me prodhim te artikujve te kerkuar madje edhe me dizenjim te tyre sipas kerkesave specifike, logove hologramave te cilat pas nje procesi kompleks prodhimi do te cojne ne perftrimin e produktit final I cili me pas do te furnizohet per autoritetin kontraktor. Pra jo iso lidhet ngushtesishte me objektin e prokurimit dhe me aftesine zbatuese te kontrates dhe sherben si garanci per autoritetin kontraktor qe kompania qe do te prodhoje keto artikuj espekton me rigorozitet dhe ploteson te gjitha masat e nevojshme per prodhimin e tyre.*

***Se treti:*** *Ne lidhje me kriterin per kualifikim te percaktuar ne piken 2.4.4 te shtojces 7,- Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij 1 (nje) dizajner qe te kete mbaruar shkollen e larte. Kjo te vertetohet me diplomen e shkolles se larte, kontraten e punes si edhe certifikaten perkatese qe virteton se punonjesi ka njohuri ne fushen e grafik-dizajnit...: eshte ekzagjeruar jo ne proporcion me objektin e prokurimit pasi artikujt objekt prokurimi jane artikuj per te cilat OE-te nuk e kane te domosdoshem qe ti kene ne staf nje dizjner, pasi jane artikuj te thjeshte, nje pjese e tyre jane te gatshem ne treg dhe vetem vendosja e logos se institucionit ne to nuk justifikon kerkesen e AK-se qe OE-te kene nje punonjes te diplomuar dhe te certifikuar ne fushen*

*e grafikes dhe dizajnit, pasi nje proces te tille mund ta bejne shume mire edhe punonjes te cilet nuk jane te specializuar ne fushen e grafikes.*

*KSHA sqaron edhe njehere qe nuk eshte e vertete qe kemi te bejme me blerje malli te paster, pasi kemi te bejme me prodhim te artikuljve te kerkuar madje edhe me dizenjim te tyre sipas kerkesave specifike, logove hologramave, te cilat pas nje procesi kompleks prodhimi do te cojne ne perftimin e produktit final i cili me pas do te furnizohet per autoritetin kontraktor. Pra kerkesa per nje dizanjer lidhet ngushtesisht me objektin e prokurimit dhe me aftesine zbatuesete kontrates dhe ashtu sic percaktohet ne specifikime operatorit do ti jepet material bruto i cili duhet te perpunohet nga izanjer i specializuar ne fushen e grafikes dhe me pas te miratohet nga OSHEE ne menyre qe te kaloje per prodhim. Kjo kerkesa nuk eshte e mbeshteturndaj KSHA nuk e panon.*

***Për sa shpjeguar me lart pretendimi i ankuesit qëndron pjeserisht.***

***6-Për sa i përket pikës së gjashtë të ankimit të paraqitur nga OE cit \****

*-Ne lidhje me kriterin per kualifikim te percaktuar ne pikes 2.4.5 te shtojces 7 te DT-se me permbajtjen si me poshte:*

*2.4.5 Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e meposhtme:*

*Makine shtypi 50x70 5 C+llak ose me permasa me te medha*

*Makine gepse me pe me permasa 35x25*

*Makine prerje me permasa 80x110*

*Makine qepese me tel*

*Thike nje anshe*

*Formatet e ketyre makinave jane formatet minimale, mund te paragiten makina me formate me te medha*

***Për sa shpjeguar me lart pretendimi i ankuesit qëndron pjeserisht.***

*KSHA sqaron se autoriteti kontraktor legjitimohet te kerkoje ne perputhje me parashikimet e nenit 40 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar, **mjetet dhe pajisjet teknike** që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. **Megjithate kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.***

*Nga ana jone vleresohet qe kriteri i vendosur per disponimin e Makinerive/pajisjeve eshte ne perputhje me specifikimet teknike dhe me artikujt te cilet jane parashikuar te furnizohen nepermjet kesaj kontrate.*

**Referuar nenit 21 "Autoriteti ose enti kontraktor"** të ligjit nr.162/2021 "Për prokurimin publik",1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligji. Ne kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mireplanifikoje ne dhe ne kohe fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontraten në përputhje me legjislacionin në fuqi.

*Kriteret per kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes e kapaciteteve të operatorëve ekonomike, të cilet, nepermjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontrates. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe telidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkalar kufijtë maksimale të përcaktuara në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lene nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.*

*Nepermjet kesaj kerkese autoriteti kontraktor kerkon te sigurohet qe operatori ekonomik disponon mjetet, ose mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik me gëllim realizimin me sukses të kontrates.*

*Akoma me tej autoriteti kontraktor e ka lene te hapur plotesimin e ketij kriteri me cfare doloj forme disponimi te njohur nga ligji, pa perjashtuar as mundesine e mbeshtetjes ne kapacitetet e operatoreve te tjere ekonomik.*

*KSHA sqaron edhe nje here qe nuk eshte e vertete qe kemi te bejme me blerje malli te paster, pasi kemi te bejme me prodhim te artikujve te kerkuar madje edhe me dizejnim te tyre sipas kerkesave specifike, logove hologramave, te cilat pas nje procesi kompleks prodhimi do te cojne ne perfundimin e produktit final i cili me pas do te furnizohet per autoritetin kontraktor. Pra kerkesa per nje dizejner lidhet ngushtesisht me objektin e prokurimit dhe me aftesine zbatuesete kontrates dhe ashtu sic përcaktohet ne specifikime operatorit do ti jepet material bruto i cili duhet te perpunohet nga dizejner i specializuar ne fushen e grafikes dhe me pas te miratohet nga*

*OSHEE ne menyre qe te kaloje per prodhim. Per prodhimin e artikujve dhe poduktit final te kerkuar sipas specifikimeve eshte e domosdoshme disponimi i ketyre pajisjeve. Ne keto kushte pretendimi se tipi I kontrates eshte mall dhe autoriteti nuk legjitimohet te kerkoje mjete nuk qendron kjo edhe per faktin qe vete neni 40 i VKM 285 parashikon mundesin per kerkimin e mjetet dhe pajisjet teknike qe sherbejne per realizimin e kontrates.*

**Marr shkas nga pretendimi i ngritur nga ankimuesi qe prodhimi i mallrave ge kerkohen te furnizohen nepermjet kesaj kontrate mund te realizohen teknikisht edhe nepermjet 1 (një) makinerie / pajisje shtypi "Makinë shtypi 50x70 4 C+ llak, pavaresisht metodologjise apo teknikes se perdorur, vleresojme qe Për sa kohe qellimi final i autoritetit kontraktor eshte te vërtetoje nëse subjektet ofertues zotërojnë ose jo kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontrates, duhet pranuar kërkesa per "Makinë shtypi 50x70 4 C +llak.**

*Për sa shpjeguem më lart pretendimi I ankimuesit qëndron pjesërisht.*

*Për sa I përket kërkesës për heqjen e mostrës KSHA në shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga "Infosoft Office" shpk ka pranuar kërkesën për heqjen e mostrës nga kjo kërkesë është pranuar tashmë dhe si e tillë nuk do të merret në shqyrtim.*

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Inpress" SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Referuar shkresës me nr. 4157/10 prot., datë 18.06.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1546/2 prot., datë 18.06.2024 me lëndë "Kthim - përgjigje", drejtuar operatorit ekonomik "Inpress" SHPK për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka përcjellë aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues "Inpress" SHPK, nga ku rezulton, se ka pranuar pjesërisht ankesën si vijon:

*I-Për sa i përket pikës së parë të ankimit të paraqitur nga OE cit\**

“[...] KSHA në shqyrtim të ankesës sqaron se:

-Është kërkuar makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me përmasa më të mëdha për vetë faktin që kjo makinë shtypi nevojitet për prodhimin e artikujve të renditur në preventivë 1-4 të cilët sipas specifikimeve teknike kërkohen të shtypen me logon e oSHEE Group të shtypur me 5 C( 4C + ngjyre special pantone orange 021 C ose ekuivalente) + llak. Nisur nga kjo specifikë autoriteti kontraktor legjitimohet të kërkojë në përputhje me parashikimet e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik **për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.**

**Megjithatë kriteret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.**

Nga na jonë vlerësohet që kriteri i vendosur për makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me përmasa më të mëdha është në përputhje me specifikimet teknike dhe me artikujt të cilët janë parashikuar të furnizohen nëpërmjet kësaj kontrate.

**Referuar nenit 21 “autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.**

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Marr shkas nga pretendimi i ngritur nga ankimuesi që prodhimi i mallrave që kërkohen të furnizohen nëpërmjet kësaj kontrate mund të realizohen teknikisht edhe nëpërmjet 1 (një) makinerie/pajisje shtypi “Makinë shtypi 50x70 4 C + llak, pavarsisht metodologjisë apo teknikës së përdorur, vlerësojmë që Për sa kohë qëllimi final i autoritetit kontraktor është të vërtetojë nëse subjektet ofertues zotërojnë ose jo kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës, duke pranuar kërkesa për për “makinë shtypi 50x70 4 C + llak”**

**Për sa shpjeguar më lart pretendimi i ankuesit qëndron.**

2-Për sa i përket pikës së dytë të ankimit të paraqitur nga OE për të cilën pretendohet se, cit\*:

“[...]Në ankesë ngrihet pretendimi se:

Nisur nga fakti që në specifikimet teknike të përcaktuara në DST të artikujve/ produkteve që kërkohet të paraqiten mostra/modele nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, nuk përcaktohet asnjë marzh dhe tolerancë +- në gramaturë.

Duke marrë gjithashtu në konsideratë që Komisioni i Prokurimit Publik me antë të disa vendimeve të tij ka skualifikuar operatorë ekonomikë pjesëmarrës pasi mostrat e dorëzuara prej

*tyre kishin një diferencë në peshë minimale më të vogël, apo më të madhe se ajo e përcaktuar në DST.*

*...por ka patur edhe rate gjithashtu që Komisioni i Prokurimit Publik me anë të disa vendimeve, ka konsideruar të rregullt ofertat e disa operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, pavarësisht faktit se peshë e letrës dhe/ose kartonit nuk ishte ekzaktesisht sa ajo e kërkuar dhe përcaktuar në DST.*

*...për të eliminuar/ shmangur cdo lloj vendimarrje diskrecionale dhe të pambështetur në kritere teknike (në të 2 rastet e lartëpërmendur) nga ana e AK dhe KPP mbi këtë kriter të përcaktuar në DST.*

*kerkojme të përcaktohet edhe marzhi dhe toleranca +/- në gramaturë, Për sa i përket peshës së letres dhe kartonit të mostrave të kërkuara në DST, si dhe nëse ekziston një tolerancë e tillë, cila/cfare tolerancë +/- është e pranueshme nga AK...*

*Per sa mesipër, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, ky kriter teknik lë vend për vendimarrje diskrecionale dhe të pambështetur në kritere objektive dhe teknike nga ana e AK dhe KPP, dhe për këtë arsye shtojca 5 "Formulari i Specifikimeve*

*teknike", të Dokumentave Standarte të Tenderit de t dubet të ndryshohet, duke përcaktuar dhe saktësuar marzhin dhe tolerancën +/- në gramaturë, Për sa i përket peshës së letres ane kartonit të mostrave të kërkuara në DST. Hartimi i specifikimeve teknike është mbështetur në vendimin nr. 1 të KLA date 18.01.2023, në të cilin nuk*

*KSHA në shqyrtimin e Ankesës lidhur me këtë shqyrtim të ngritur armenton është parashikuar marzh apo tolerancë +/- në gramaturë. Duke qenë se nuk ekziston një standart kombëtar apo ndërkombëtar ku ta mbështesni kërkesën tuaj për të parashikuar marzh apo tolerancë +/- në gramaturë, vlerësojmë se nuk është mbështetur kërkesa juaj dhe si e tillë nuk mund të pranohet.*

*Për sa shpjegojmë me lart pretendimi i ankuarit për marzh apo tolerancë +/- në gramaturë nuk qëndron.*

*Theksojmë se duke marrë në konsideratë shqyrtimin e ngritur lidhur me testimin e mostrave dhe rezultatet e perftuara, mendojmë se duke qenë se mostrat e kërkuara zënë një peshë specifike minimale në raport me të gjithë zerat e tjere, për të shmangur problematikat në vlerësim dhe për të eliminuar në maksimum kontestimet konkudojmë se për një vlerësim sa më objektiv dhe të barabart për të gjithë operatorët kriteri për paraqitjen e mostrave të hiqet”.*

*III.1.2. Neni 30 i LPP-së, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrtonte ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit*

115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Sa më sipër, KPP do të mbyllë shqyrtimin, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, për sa kohë rezultojnë, se janë pranuar nga autoriteti kontraktor.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,



III.2.1 Me anë të shkresës së ardhur nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1589/2 prot., datë 21.06.2024, me lëndë “Shqyrtim ankesë”, drejtuar operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka përcjellë aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Infosoft Office” SHPK, nga ku rezulton se ka pranuar pjesërisht:

*Për sa i përket pikës së parë të ankimit të paraqitur nga OE cit:*

*KSHA në shqyrtim të ankesës sqaron se:*

*OSHEE Group sh.a është ent kontraktor i cili prokuron mallra, pune dhe shërbime me fondet e veta, të cilat miratohen çdo vit nga Këshilli Mbiqyres dhe Asambleja.*

*Buxheti për vitin 2024 është miratuar në 12 prill 2024, ndaj në këto kushte ka qene e pamundur të përmbushen kërkesat e VKM 360 date 26.04.2017 ndryshuar me VKM 331 date 22.05.2019 dhe VKM 608 date 22.09.2022, nëni 4/1, pika 3 ku shprehet se çdo vit brenda datës 1 mars autoritetet ose entet kontraktor i dergojne Drejtorise se Pergjithshme te Arkivave, specifikimet teknike, kërkesat sasiore dhe fondin limit. Kërkesat e derguar pas s kesaj date muk do te merren parasyshe per prokurim per vitin pasardhes.*

*Në kushtet kur OSHEE Group sh.a nuk kishte buxhet të miratuar ishte e pamundur të përmbushesh kërkesa e nënit 4/1 pika 3, pasi nuk mund të përlllogaritej fond limit pa ze të buxhetuar.*

*Sjellim në vëmendje se me VKM 608 date 22.09.2022 nëni 4 shkronjat "T" dhe "II" dhe shkronja "m" janë shfuqizuar dhe është shtuar nëni 4/1 me përmbajtje si vijon:*

*Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen blerjen e përqendruar për të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për furnizimin me kuti dhe dosje të standardit të përhershëm, përfshirë edhe etiketat e tyre. Procedura e prokurimit kryhet çdo vit për vitin pasardhës, duke marrë parasyshe në këtë procedurë edhe shtrirjen gjeografike të vendruajtjes depozituese finale të dokumentacionit arkivor, për të cilin kryhet blerja e përqendruar.*

*2. Brenda datës 1 shkurt të çdo viti, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave njofton përmes rruges shkresore dhe /ose elektronike autoritetet dhe entet kontraktore për:*

- a) standardet kombëtare të miratuara për kutitë dhe dosjet e standardit të përhershëm;*
- b) çmimin për njësi të llogaritur përmes parashikimeve ligjore, e indeksuar me ndryshimet e mundshme të evidentuara gjatë studimit paraprak të tregut, të kryer prej saj.*

3. Brenda datës 1 mars, autoritetet ose entet kontraktore i dërgojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave specifikimet teknike, kërkesat sasiore dhe fondin limit. Kërkesat e dërguara pas kësaj date nuk merren parasysh për prokurimin për vitin pasardhës.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen procedurën e prokurimit nga procesi i njoftimit të kontratës deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuader. sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

5. Per çdo kontrate të lidhur nga autoritetet dhe entet kontraktore, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen verifikimin paraprak të cilësisë Për sa i përket jetëgjatësisë së kutive dhe dosjere standardit të përhershëm, sipas udhëzimeve administrative të saj. Autoritetet ose entet kontraktore marrin në dorëzim kutitë dhe dosjet bashkë me dokumentacionin shoqëruar të verifikimit paraprak të cilësisë.”

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

***Duke qene se neni 4/1 nuk ndalon krverien e procedurave te prokurimit nga entet kontraktore qe prokurojne materiale arkive per ruajtje jo te perhershme vleresojme se parashtrimi juaj dhe analiza e bere lidhur me kete ceshtje nuk qendron, ndaj rrjedhimisht nuk mund te merret parasysh kerkesa per anullimin e kesaj procedure.***

***Për sa shpjeguar me lart pretendimi i ankuesit nuk qëndron.***

***2-Për sa i përket pikës së dytë të ankimit të paraqitur nga OE cit\*;***

*Per te gjithë artikujt e perfshire ne kete procedure prokurimi, parametrat jane fikse dhe nuk eshte vendosur asnje marzh ne plus apo minus ne raport me parametrat e vendosuar per artikujt nga AK-ja, pra kufijte brenda te cilave lejohen plus dhe minus, Për sa i përket parametrave të permasave dhe të peshes. Ne lidhje me hartimin e specifikimeve teknike të artikujve objekt i këtij prokurimi nga AK-ja në procesverbalin e hartimit të dokumentave nuk është dhënë asnjë argument në lidhje me hartimin e tyre. Nga autoriteti kontraktor në procesverbalin e hartimit të dokumentave është percaktuar vetëm fakti që, specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga struktura e posaçme e ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor, por pa dhënë asnjë argument për operatorët ekonomikë në lidhje me arsyet e AK-se për percaktimin e këtyre parametrave fikse dhe pa lejuar asnjë marzh me plus apo minus të këtyre parametrave, brenda të cilave artikujt janë të pranueshëm nga autoriteti kontraktor. Mos percaktimi për parametrat e permasave apo të peshes së kerkuar me marzhe të lejueshme, sjell kufizim të pjesmarrjes dhe orientim drejt artikujve të vecante pra, drejt prodhuesve të vecante. Kjo vjen në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik....*

***KSHA ne shqyrtimin e Ankeses lidhur me kete pike argumenton:***

*Hartimi i specifikimeve teknike eshte mbeshtetur edhe ne vendimin nr. I te KLA date 18.01.2023, ne te cilin nuk eshte parashikuar marzh apo tolerance +/- në gramaturë. Duke qene se nuk ekziston nje standart kombetar apo nderkombetar ku ta mbeshtesni kerkesen tuaj per te parashikuar marzh apo tolerance +/- ne gramature, vleresojme se nuk eshte e mbeshtetur kerkesa juaj.*

*Po ashtu kerkesa juaj per percaktimin e nje marzhi te lejuar ne plus dhe ne minus prej 5% si Për sa i perket permasave ashtu edhe per sa i perket peshes se kerkuar nuk rezulton te jete e mbeshtetur ne ndonje specifike te miratuar nga organe kompetente apo nga standarte shteterore ne fuqi ndaj kjo kerkesa nuk mund te pranohet.*

*Por duke marre ne kosiderate shqetesimin e ngritur edhe nga ankesa e paraqitur nga subjekti Inpress sh.p.k lidhur me testimin e mostrave dhe rezultatet e perftuara, duke qene se mostrat e kerkuara zene nje peshe specifike minimale ne raport me te gjithë zerat e tjere, per te shmangur problematikat ne vleresim dhe per te eliminuar ne maksimum kontestimet eshte vendosur se per nje vleresim sa me objektiv dhe te barabarte kriteri per paraqitjen e mostrave te hiqet.*

***Për sa shpjeguem me lart pretendimi i ankuesit nuk qëndron.***

***3-Për sa i përket pikës së tretë të ankimit të paraqitur nga OE cit \*;***

*Kerkojme sakesime ne lidhje me produktet si me poshte:*

- 1. Per artikullin me numer rendor 3 (Dosje te shtypura me Format 50x70, permasa 33x25.5) me specifikimet teknike:me specifikimet teknike:*
- 2. Per artikullin me numer rendor 4 (Dosje te shtypura me Format 50x70, permasa 22x32),*
- 3. Per artikullin me numer rendor 19 (Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26) me specifikimet teknike:*

***KSHA ne shqyrtimin e Ankeses lidhur me kete pike sqaron:***

*Lidhur me konstatimet per piken 1 dhe 2 e gjen te drejte kerkesen tuaj dhe vendos ta pranoje me qellim sakesimin dhe percaktimin e sakte te formatit dhe permasave te dosjeve tek skicat.*

*Gjithashtu edhe per artikullin "Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26" e gjejme te drejte konstatimin dhe do te publikohet foto e sakte*

*-Për sa i përket pikës së katërt të ankimit të paraqitur nga OE cit \**

*-ne lotin e dyte jane perfshire gjithshu artikui te cilet iane shtypshkrime si artikujt me numral rendore si me poshte:*

*5 (Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve); 6 (Regjister dhenie- marrje dokumentash):*

*9 (Formular dorezim materialesh ne arkive); 10 (Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave):*

*11 (Fletehyrje e perkohshme ne arkive); 13 (Fletepalosje A4);*

*14 (Fletepalosje 20x21):*

*15 (Postera 40x58);*

*16 (Postera 50x70)*

*17(Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18);*

*18 (Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9); 19 (Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26).*

*Perfshirja e artikujve te mesiperm ne kete procedure prokurimi, nderkohe qe AK-ja shypshkrimet i ka percaktur ne lotin e pare te kesaj procedure vjen ne kundershtrim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik....*

#### ***KSHA ne shqyrtimin e Ankeses lidhur me kete pike sqaron:***

*Ne lotin e dyte jane perfshire te gjitha artikujt qe lidhen ngushtesisht me proceduren e ruajtjes dhe arkivimit te dokumentacionit. Pra materialet jane grupuar ne lote te vecanta duke u nisur nga qellimi per te cilen blihen dhe nga funksioni qe kerkohet te kryejne. Pra ne lotin e dyte jane grumbulluar te gjitha artikujt te cilet lidhen ngushtesisht me procesin e arkivimit pra qe karakteristika te perbashketa dhe jane te nevojshme per te kryer procesin e arkivimit sic kerkohet nga specifikime. Te gjitha artikujt e listuar nga ana juaj i sherbejne ngushtesisht procesit te arkivimit te dokumentacionit dhe nuk mund te shkeputen dhe te trajtohen vecmas.*

*Te gjitha keto artikuj duhet te prodhohen sipas kerkesave dhe specifikime te vendosura nga autoriteti, pra keto artikuj do te jepen bruto dhe duhet te dizenjohen dhe pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim.*

*Sqarojme se te gjitha artikujve si dosje, kuti, etiketa, nuk mund te blihen te gatshme nga subjekte qe i tregetojne pasi ato duhet te prodhohen dhe realizohen nga operatori ekonomik ne perputhje me kerkesat specifikimet vetem pasi te dizenjohen dhe te miratohen nga OSHEE Group sh.a. Nuk kemi te bejme me blerje te produkteve te gatshme.*

***Për sa shpjeguem me lart pretendimi i ankuesit nuk qëndron.***

## **5-Përsa i përket pikës së pestë të ankimit te paraqitur nga OE cit;**

- ISO 16245 ose ekuivalent (per prodhimin e kutive dhe te materialeve te tjera, me celuloze, per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve) (e vlefshme, e akredituar nga DPA nga Organizma Nderkombetare Akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

**Se pari:** KSHA e gjen te mbeshtetur kerkesen tuaj per sa i perket ndryshimit qe duhet bere ne Formulimin qe: Operatori Ekonomik duhet te paraqese certifikata te vlefshme me objekt te njejte me objektin e prokurimit dhe ka vendosur ta pranoje kerkesen tuaj duhe e formuluar kete kerkese si vijon:

**-Operatori Ekonomik duhet te paraqese certifikata te vlefshme objekti i te ciles perputhet me fushen e objektit te prokurimit.**

**Se dyti:** KSHA e gjen te pa argumentuar kerkesen per heqjen e ISO 16245 ose ekuivalent pasi kjo iso verteton qe OE ofertues ne procesin e prodhimit respekton me rigorozitet dhe ploteson te gjitha masat e nevojshme per prodhimin e kutive dhe kapakeve te perbera nga material celuloze, te cilat perdoren per arkivimin e dokumenteve shkresore per nie periudhe te gjate kohe. Nuk eshte e vertete qe kemi te bejme me blerje malli te paster, pasi kemi te bejme me prodhim te artikujve te kerkuar madje edhe me dizenjim te tyre sipas kerkesave specifike, logove hologramave te cilat pas nje procesi kompleks prodhimi do te cojne ne perfimin e produktit final I cili me pas do te furnizohet per autoritetin kontraktor. Pra jo iso lidhet ngushtesishte me objektin e prokurimit dhe me aftesine zbatuese te kontrates dhe sherben si garanci per autoritetin kontraktor qe kompania qe do te prodhoje keto artikuj espekton me rigorozitet dhe ploteson te gjitha masat e nevojshme per prodhimin e tyre.

**Se treti:** Ne lidhje me kriterin per kualifikim te percaktuar ne piken 2.4.4 te shtojces 7,- Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij I (nje) dizajner qe te kete mbaruar shkollen e larte. Kjo te vertetohet me diplomen e shkolles se larte, kontraten e punes si edhe certifikaten perkatese qe verteton se punonjesi ka njohuri ne fushen e grafik-dizajnit...: eshte ekzagjeruar jo ne proporcion me objektin e prokurimit pasi artikujt objekt prokurimi jane artikuj per te cilat OE-te nuk e kane te domosdoshem qe ti kene ne staf nje dizjner, pasi jane artikuj te thjeshte, nje pjese e tyre jane te gatshem ne treg dhe vetem vendosja e logos se institucionit ne to nuk justifikon kerkesen e AK-se qe OE-te kene nje punonjes te diplomuar dhe te certifikuar ne fushen e grafikes dhe dizajnit, pasi nje proces te tille mund ta bejne shume mire edhe punonjes te cilet nuk jane te specializuar ne fushen e grafikes.

KSHA sqaron edhe njehere qe nuk eshte e vertete qe kemi te bejme me blerje malli te paster, pasi kemi te bejme me prodhim te artikujve te kerkuar madje edhe me dizenjim te tyre sipas kerkesave specifike, logove hologramave, te cilat pas nje procesi kompleks prodhimi do te cojne ne perfimin e produktit final i cili me pas do te furnizohet per autoritetin kontraktor. Pra kerkesa per nje dizanjer lidhet ngushtesisht me objektin e prokurimit dhe me aftesine zbatuesete

kontrates dhe ashtu sic percaktohet ne specifikime operatorit do ti jepet material bruto i cili duhet te perpunohet nga izanjer i specializuar ne fushen e grafikes dhe me pas te miratohet nga OSHEE ne menyre qe te kaloje per prodhim. Kjo kerkese nuk eshte e mbeshteturndaj KSHA nuk e panon.

***Për sa shpjeguar me lart pretendimi i ankuesit qëndron pjeserisht.***

#### ***6-Për sa i përket pikës së gjashtë të ankimit të paraqitur nga OE cit \****

-Ne lidhje me kriterin per kualifikim te percaktuar ne pikes 2.4.5 te shtojces 7 te DT-se me permbajtjen si me poshte:

2.4.5 Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e meposhtme:

*Makine shtypi 50x70 5 C+llak ose me permasa me te medha*

*Makine gepse me pe me permasa 35x25*

*Makine prerje me permasa 80x110*

*Makine qepese me tel*

*Thike nje anshe*

*Formatet e ketyre makinave jane formatet minimale, mund te paragiten makina me formate me te medha*

***Për sa shpjeguar me lart pretendimi i ankuesit qëndron pjeserisht.***

***KSHA sqaron se autoriteti kontraktor legjitimohet te kerkoje ne perputhje me parashikimet e nenit 40 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Megjithate kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.***

*Nga ana jone vleresohet qe kriteri i vendosur per disponimin e Makinerive/pajisjeve eshte ne perputhje me specifikimet teknike dhe me artikujt te cilet jane parashikuar te furnizohen nepermjet kesaj kontrate.*

***Referuar nenit 21 "Autoriteti ose enti kontraktor" të ligjit nr.162/2021 "Për prokurimin publik",1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligji. Ne kuptim te kisaj pike, autoriteti ose enti***

*kontraktor ka detyrimin te mireplanifikoje ne dhe ne kohe fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratenne përputhje m legjislacionin ne fuqi.*

*Kriteret per kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes e kapaciteteve te operatorëve ekonomike, të cilet, nepermjet dokumentacionit të paraqitur duhet t vertetojne se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerinë, përvojen e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses te kontrates. Bazuar në ligiin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejten e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe telidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimale te percaktuar në këtë të fundit, ne funksion të qëllimit dhe parimevete ligjit për prokurimin publik Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe percaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lene nen përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë ne përputhje e përpjesetim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.*

*Nepermjet kesaj kerkese autoriteti kontraktor kerkon te sigurohet ge operatori ekonomik disponon mjetet, ose mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik me gellim realizimin me sukses te kontrates.*

*Akoma me tej autoriteti kontraktor e ka lene te hapur plotesimin e ketij kriteri me cfaredolloj forme disponimi te njohur nga ligji, pa perjashtuar as mundesine e mbeshtetjes ne kapacitetet e operatoreve te tjere ekonomik.*

*KSHA sqaron edhe njehere qe nuk eshte e vertete ge kemi te bejme me blerje malli te paster, pasi kemi te bejme me prodhim te artikujve te kerkuar madje edhe me dizenjim te tyre sipas kerkesave specifike, logove hologramave, te cilat pas nje procesi kompleks prodhimi do te cojne ne perftimin e produktit final i cili me pas do te furnizohet per autoritetin kontraktor. Pra kerkesa per nje dizanjer lidhet ngushtesisht me objektin e prokurimit dhe me aftesine zbatuesete kontrates dhe ashtu sic percaktohet ne specifikime operatorit do ti jepet material bruto i cili duhet te perpunohet nga dizanjer i specializuar ne fushen e grafikes dhe me pas te miratohet nga OSHEE ne menyre qe te kaloje per prodhim. Per prodhimin e artikujve dhe produktit final te kerkuar sipas specifikimeve eshte e domosdoshme disponimi i ketyre pajisjeve. Ne keto kushte pretendimi se tipi I kontrates eshte mall dhe autoriteti nuk legjitimohet te kerkoje mjete nuk qendron kjo edhe per faktin qe vete neni 40 i VKM 285 parashikon mundesin per kerkimin e mjetet dhe pajisjet teknike qe sherbejne per realizimin e kontrates.*

**Marr shkas nga pretendimi i ngritur nga ankimesi qe prodhimi i mallrave ge kerkohen te furnizohen nepermjet kesaj kontrate mund te realizohen teknikisht edhe nepermjet I (një)**

**makinerie / pajisje shtypi "Makinë shtypi 50x70 4 C+ llak, pavaresisht metodologjise apo teknikes se perdorur, vleresojme qe Për sa kohe qellimi final i autoritetit kontraktor eshte te vërtetoje nëse subjektet ofertues zotërojnë ose jo kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontrates, duhet pranuar kërkesa per "Makinë shtypi 50x70 4 C +llak.**

*Për sa shpjeguar më lart pretendimi I ankimuesit qëndron pjesërisht.*

*Për sa I përket kërkesës për heqjen e mostrës KSHA në shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga "Infosoft Office" shpk ka pranuar kërkesën për heqjen e mostrës nga kjo kërkesë është pranuar tashmë dhe si e tillë nuk do të merret në shqyrtim [...]"*

III.2.2. Neni 30 i LPP-së, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.2.3. Neni 115 pika 1, 2 dhe 3 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të*



*ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.*

*3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:*

*a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;*

*b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.*

Sa më sipër, KPP do të mbyllë shqyrtimin, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, që rezultojnë, se janë pranuar nga autoriteti kontraktor.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit me arsyetimin se: “...Së PARI: Paraprakisht po ju sjellim në vëmendje se, procedura e prokurimit objekt i këtij ankimi, është pjesë e procedurës së prokurimit me objekt: Shtypshkrime dhe materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.â e ndarë në dy lote, ku Loti i parë është me objekt: ðShtypshkrime për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijaveÿ dhe Loti i dytë është me objekt: Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijaveÿ; Në listën e mallrave të përcaktuara në dokumentat e tenderit, të kësaj procedure prokurimi janë përcaktuar ndër të tjera edhe artikuj e emërtuar si më poshtë: Artikulli me numrin rendor 17 me specifikimet teknike: Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18- Ndërtuar nga karton i fortë e i valÿzueshëm, me gramatur 620 gr/m2 që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura Artikulli me numrin rendor 18 me specifikimet teknike: Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9- Ndërtuar nga karton i fortë e i vazhzeshëm, me gramatur 620 gr/m2 që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitÿse ose të kapuraÿ. Artikulli me numrin rendor 18 me specifikimet teknike: Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37xx26 Kartoni të jetë 330 gr/m2, me 2 krahë, krahÿt të brendashkruar të palosura 20 cm, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. Të ketë një

*pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapurî. Përfshirja e artikujve të dosjeve dhe kutive per ruajtje të përhershme në këtë procedurë prokurimi është në shkelje të akteve ligjore në fuqi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit “Formulari i specifikimeve teknike” autoriteti kontraktor ka parashikuar:

### ***II-Specifikimet teknike të materialeve të arkivës Loti i Dyte:***

- 1. Kuti kartoni 40 x 28 x 18 cm. Materiali qe do te perdoret do te jete karton i ngurte me permasa 78x109, I paprere, me peshe 2000 gr/m2. Do te kete dy kapake, te gjitha kendet do te jene 90 grade, te gjitha brinjjet do te lidhen me beze. Kjo veshje behet per te siguruar ngjitjen. Kutia te jete me suprine 80 gr/m2 me ngjyre. Vendoset edhe nje lidhese per terheqje.*
- 2. Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 37x26 cm me llape 18 cm me dy llapa te palosura (me gjeresi 6.5 cm secila ne nje trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje, me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. 0*
- 3. Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 33x25.5 cm me llape 10 cm me dy llapa te palosura (me gjeresi 6.5 cm secila ne nje trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 3)*
- 4. Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 22x32 cm me llape 9 cm me dy llapa te palosura dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 4)*
- 5. Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve ne arkive me leter kimike 1,2 me nurmer serie, blloqe me 100 flete, ne format A4, me logon e OSHEE Group.*
- 6. Regjister dhenie- marrje dokumentashne format A3, me leter 80 gr/m2me logon e OSHEE Group.*
- 7. Etiketa per kuti per arkiven qendrore (formati 14x19 me logon e OSHEE Group me leter adezive) te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.*

8. *Etiketa per kuti per arkiven e rretheve (formati 14x9 me logon e OSHEE Group me leter adezive) te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
9. *Formular dorezim materialesh ne arkive me leter 80 gr offset, format A4 me logon e OSHEE Group me 5C + llak.*
10. *Regjister per dorezimin e inventareve te dokumenteve me format 25x35 cm. Faqet e brendshme me leter offset 80 gr/m2. me 200 faqe, me qepje me pe. Te shtypet ne format 50x70 ose 70x100 ku te formohet fashikulli me 8 faqe ose me 16 faqe ne menyre qe te realizohet qepja. Kapaku te behet me punim special me karton 1500 gr/m2, me qafallare dhe me fjongo. Kapaku te mbeshtillet me suprine me leter 170 gr/m2 e cila te jete e shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + boje special pantone orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
11. *Fletehyrje e perkohshme ne arkive (format A4 me leter 80 gr/m2 e ndare ne mes, me biosje, blloqe me 100 flete)me logon e OSHEE Group.*
12. *Kuti me lidhese me karton 700 gr/m2 me lidhese me suprine me beze me shpine 10 cm me permasa 23x33.*
13. *Fletepalosje A4 me leter 170 gr/m2te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
14. *Fletepalosje 20x21 leter 170 gr/m2m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
15. *Postera 40x58 me leter adezive 200 gr/m2m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
16. *Postera 50x70 me leter adezive 200 gr/m2 m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*

17. Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18- Ndërtuar nga karton i fortë e i valzueshëm, me gramatur 620 gr/m<sup>2</sup> që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.

18. Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9- Ndërtuar nga karton i fortë e i valzueshëm, me gramatur 620 gr/m<sup>2</sup> që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.

19. Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26 – Kartoni të jetë 330 gr/m<sup>2</sup>, me 2 krahë, krahët të brendashkruar të palosura 20 cm, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.

**Sasite e parashikuar per secilen kompani per materialete arkives dhe perllogaritja e fondit limit:**

<b>MATERIALE ARKIVE</b>				<b>Viti 2024</b>				
<b>Nr</b>	<b>Pershkrimi i materialit</b>	<b>Njesia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>OSSH</b>	<b>OSHEE</b>	<b>FSHU</b>	<b>Total</b>	<b>Vlera</b>
				<b>Sasia</b>			<b>Sasia</b>	
1	Kuti kartoni (40x28x18 )	cope		5,000	70,000	4,500	79,500	
2	Dosje te shtypura me Format 50x70, permasa 37x26	cope		1,200	30,000	500	31,700	
3	Dosje te shtypura me Format 50x70, permasa 33x25.5	cope		1,200	15,000	500	16,700	
4	Dosje te shtypura me Format 50x70, permasa 22x32	cope		1,200	15,000	500	16,700	

5	<i>Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve</i>	<i>cope</i>		1,000	1,000	1,000	3,000	
6	<i>Regjister dhenie- marrje dokumentash</i>	<i>cope</i>		100	1,500	50	1,650	
7	<i>Etiketa per kuti per arkiven qendrore</i>	<i>cope</i>		0	1,000	0	1,000	
8	<i>Etiketa per kuti per arkivat e rretheve</i>	<i>cope</i>		1,000	0	0	1,000	
9	<i>Formular dorezim materialesh ne arkive</i>	<i>cope</i>		50	500	50	600	
10	<i>Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave</i>	<i>cope</i>		150	1,000	100	1,250	
11	<i>Fletehyrje e perkohshme ne arkive</i>	<i>cope</i>		100	500	100	700	
12	<i>Kuti me lidhese me karton</i>	<i>cope</i>		1,200	10,000	500	11,700	
13	<i>Fletepalosje A4</i>	<i>cope</i>		0	1,000	0	1,000	
14	<i>Fletepalosje 20x21</i>	<i>cope</i>		0	1,000	0	1,000	
15	<i>Postera 40x58</i>	<i>cope</i>		0	500	0	500	
16	<i>Postera 50x70</i>	<i>cope</i>		0	500	0	500	
17	<i>Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18</i>	<i>cope</i>		0	50	0	50	
18	<i>Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9</i>	<i>cope</i>		0	50	0	50	
19	<i>Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26</i>	<i>cope</i>		0	50	0	50	
							<b>Totali</b>	<b>22,729,430</b>

*\*Afatet e lëvrimit: 45 dite nga data e nenshkrimit te kontrates.*

**ADRESAT KU DO TE LEVROHET MALLI: Magazina Qendrore e OSHEE Group Tirane.**

**Per efekt ilustrimi per secilin artikull vendosen pamjet/skicat perkatese, te cilat do ti gjeni bashkelidhur.**

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.3.3. Në nenin 4/1 “Blerja e përqendruar” të VKM nr. 360, datë 26.4.2017 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen blerjen e përqendruar për të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për furnizimin me kuti dhe dosje të standardit të përhershëm, përfshirë edhe etiketat e tyre. Procedura e prokurimit kryhet çdo vit për vitin pasardhës, duke marrë parasysh në këtë procedurë edhe shtrirjen gjeografike të vendruajtjes deponituese finale të dokumentacionit arkivor, për të cilin kryhet blerja e përqendruar.

2. Brenda datës 1 shkurt të çdo viti, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave njofton përmes rrugës shkresore dhe/ose elektronike autoritetet dhe entet kontraktore për: a) standardet kombëtare të miratuara për kutitë dhe dosjet e standardit të përhershëm; b) çmimin për njësi të llogaritur përmes parashikimeve ligjore, e indeksuar me ndryshimet e mundshme të evidentuara gjatë studimit paraprak të tregut, të kryer prej saj.

3. Brenda datës 1 mars, autoritetet ose entet kontraktore i dërgojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave specifikimet teknike, kërkesat sasiore dhe fondin limit. Kërkesat e dërguara pas kësaj date nuk merren parasysh për prokurimin për vitin pasardhës.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen procedurën e prokurimit nga procesi i njoftimit të kontratës deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

5. Për çdo kontratë të lidhur nga autoritetet dhe entet kontraktore, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen verifikimin paraprak të cilësisë për sa i përket jetëgjatësisë së kutive dhe dosjeve të standardit të përhershëm, sipas udhëzimeve administrative të saj. Autoritetet ose entet kontraktore marrin në dorëzim kutitë dhe dosjet bashkë me dokumentacionin shoqërues të verifikimit paraprak të cilësisë.”

III.3.4. Në nenin 4 “Parimi i ligjshmërisë” të ligjit nr. Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: “1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. 2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.”.

III.3.5. Në nenin 11 “Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit” të ligjit nr. Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: “Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) është i parashikuar me ligj;

b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;

c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe;

ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme.”.

III.3.6. Në nenin 104, pika 4 “Fillimi dhe përfundimi i pasojave juridike të aktit administrativ” të ligjit nr. Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: “Një akt administrativ sjell pasoja juridike:

a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore;

b) për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij; ose

c) për çfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji.”.

III.3.7. Në nenin 107 “Ligjshmëria e aktit administrativ” të ligjit nr. Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: *“Akti administrativ është i ligjshëm nëse është nxjerrë nga organi publik kompetent, në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore të parashikuara në këtë Kod, si dhe legjislacionin në fuqi”*.

III.3.8. Në nenin 108 “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm” të ligjit nr. Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: *“Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:*

*a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:*

*i) kompetencën e organit publik;*

*ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose*

*iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;*

*b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën veprë penale;*

*c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;*

*ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.”*.

III.3.9. Në nenin 109 “Paligjshmëria e aktit administrativ” të ligjit nr. Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:*

*a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;*

*b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;*

*c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;*

*ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;*

*d) është në kundërshtim me ligjin material;*

*dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo*

*e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.”*.

III.3.10. Në nenin 110 “Pasojat dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute” të ligjit nr. Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.*

*2. Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit.*



3. Në rast se një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme dhe kjo pjesë është aq e rëndësishme sa që organi publik nuk do ta kishte nxjerrë aktin pa të, i gjithë akti është i absolutisht i pavlefshëm.”.

III.3.11. Në nenin 111 “Konstatimi i detyrueshëm i aktit absolutisht të pavlefshëm” të ligjit nr. Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: “*Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi.*”.

III.3.12. Në nenin 113 “Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit” të ligjit nr. Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: “1. *Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.*

2. *Anulimi i një akti administrativ ka pasoja për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.*

3. *Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.”.*

III.3.13. Në nenin 117 “Afati për anulimin dhe shfuqizimin” të ligjit nr. Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: “1. *Shfuqizimi, në rastin e parashikuar në pikën 1, të nenit 116, të këtij Kodi, mund të bëhet në çdo kohë.* 2. *Në çdo rast tjetër, të ndryshëm nga ai i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, anulimi ose shfuqizimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet që çojnë në anulimin ose shfuqizimin, por jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ.”.*

III.3.14. Lidhur me pretendimin më sipër të operatorit ekonomik ankimes, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor protokolluar me nr. 1589/2 prot., datë 21.06.2024, KPP konstaton, se vendimi i autoritetit kontraktor për zhvillimin e kësaj procedurë prokurimi që ka si objekt blerjen e dosjeve/kutive të arkivës, nuk është në përputhje me ligjin sektorial në fuqi e konkretisht me nenin 4/1 “Blerja e përqendruar” të VKM nr. 360, datë 26.4.2017 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen blerjen e përqendruar për të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për furnizimin me kuti dhe dosje të standardit të përhershëm, përfshirë edhe etiketat e tyre. Procedura e prokurimit kryhet çdo vit për vitin pasardhës, duke marrë parasysh në këtë procedurë edhe shtrirjen gjeografike të vendruajtjes deponituese finale të dokumentacionit arkivor, për të cilin kryhet blerja e përqendruar.” Vendimi i autoritetit kontraktor për zhvillimin e kësaj procedure prokurimi, me qëllim blerjen e dosjeve/kutive të arkivës, nuk është në përputhje me legjislacionin e sipërcituar, pasi Drejtoria e

Përgjithshme e Arkivave është i vetmi organ i ngarkuar me ligj që ka të drejtë të kryejë prokurimin e dosjeve për përdorim arkivor. Akoma më tej, KPP konstaton, se vetë autoriteti kontraktor në shtojcën 5 “SPECIFIKIMET TEKNIKE” lidhur me sasinë e artikujve që kërkohen, ka përcaktuar dosje/kuti për ruajtje të përhershme për artikullin nr. 17, artikullin nr. 18, artikullin nr. 19 si vijon ; 17. Kutë për ruajtje të përhershme me permasa 40x28x18- Ndërtuar nga karton i fortë e i valzueshëm, me gramatur 620 gr/m<sup>2</sup> që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. 18. Kutë për ruajtje të përhershme me permasa 40x70x9- Ndërtuar nga karton i fortë e i valzueshëm, me gramatur 620 gr/m<sup>2</sup> që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. 19. Dosje për ruajtje të përhershme me permasa 37xx26 – Kartoni të jetë 330 gr/m<sup>2</sup>, me 2 krahë, krahët të brendashkruar të palosura 20 cm, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.

Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon, se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, konkretisht të urdhrimit të prokurimit të dalë për kryerjen e kësaj procedure prokurimi, dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, konstaton se akti administrativ i sipërcituar i organit publik Operatorit të Shpërndarjes së energjisë Elektrike për kryerjen e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim të plotë me rregullat e prokurimit publik dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 26.4.2017 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, i ndryshuar, duke kryer për pasojë dhe shkelje procedurale, pasi autoriteti kontraktor ka ndërmarrë veprime tej kompetencës së përcaktuar në ligj për zhvillimin e një procedure prokurimi, pasi është Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave që kryen blerjen e përqendruar për të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për furnizimin me kuti dhe dosje të standardit të përhershëm. Në këtë kuadër duke qenë se autoriteti kontraktor ka kryer shkelje procedurale, si dhe ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik si dhe me legjislacionin sektorial në fuqi, KPP gjykon, se kjo procedurë prokurimi duhet anuluar.

III.4 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit me arsyetimin si vijon: “[...]Për të gjithë artikujt e përfshirë në këtë procedurë prokurimi, paramentrat janë fikse dhe nuk është vendosur asnjë marzh në plus apo minus në raport me parametrat e vendosur për artikujt nga AK-ja, pra kufijtë brenda të cilave lejohen plus dhe minus, Për sa i përket parametrave të përmasave dhe të peshës. [...]Për të gjithë artikujt sa më sipër kërkohet që artikujt të përfshirë në këtë procedurë prokurimi të përcaktohet një marzh i lejuar në plus dhe në minus prej 5 % si Për sa i përket përmasave ashtu edhe Për sa i përket peshës së kërkuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren,

III.4.1. Në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit “Formulari i specifikimeve teknike” autoriteti kontraktor ka parashikuar:

#### ***II-Specifikimet teknike të materialeve të arkivës Loti i Dyte:***

- 1. Kuti kartoni 40 x 28 x 18 cm. Materiali që do të perdoret do të jete karton i ngurte me permasa 78x109, I paprere, me peshe 2000 gr/m2. Do të kete dy kapake, te gjitha kendet do të jene 90 grade, te gjitha brinjjet do të lidhen me beze. Kjo veshje behet per te siguruar ngjitjen. Kutia te jete me suprine 80 gr/m2 me ngjyre. Vendoset edhe nje lidhese per terheqje.*
- 2. Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 37x26 cm me llape 18 cm me dy llapa te palosura (me gjeresi 6.5 cm secila ne nje trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje, me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. 0*
- 3. Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 33x25.5 cm me llape 10 cm me dy llapa te palosura (me gjeresi 6.5 cm secila ne nje trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 3)*
- 4. Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 22x32 cm me llape 9 cm me dy llapa te palosura dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 4)*
- 5. Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve ne arkive me leter kimike 1,2 me nurmer serie, blloqe me 100 flete, ne format A4, me logon e OSHEE Group.*
- 6. Regjister dhenie- marrje dokumentashne format A3, me leter 80 gr/m2me logon e OSHEE Group.*

7. *Etiketa per kuti per arkiven qendrore (formati 14x19 me logon e OSHEE Group me leter adezive) te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
8. *Etiketa per kuti per arkiven e rretheve (formati 14x9 me logon e OSHEE Group me leter adezive) te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
9. *Formular dorezim materialesh ne arkive me leter 80 gr offset, format A4 me logon e OSHEE Group me 5C + llak.*
10. *Regjister per dorezimin e inventareve te dokumenteve me format 25x35 cm. Faqet e brendshme me leter offset 80 gr/m2. me 200 faqe, me qepje me pe. Te shtypet ne format 50x70 ose 70x100 ku te formohet fashikulli me 8 faqe ose me 16 faqe ne menyre qe te realizohet qepja. Kapaku te behet me punim special me karton 1500 gr/m2, me qafallare dhe me fjongo. Kapaku te mbeshtillet me suprine me leter 170 gr/m2 e cila te jete e shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + boje special pantone orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
11. *Fletehyrje e perkohshme ne arkive (format A4 me leter 80 gr/m2 e ndare ne mes, me biosje, blloqe me 100 flete)me logon e OSHEE Group.*
12. *Kuti me lidhese me karton 700 gr/m2 me lidhese me suprine me beze me shpine 10 cm me permasa 23x33.*
13. *Fletepalosje A4 me leter 170 gr/m2te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
14. *Fletepalosje 20x21 leter 170 gr/m2m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
15. *Postera 40x58 me leter adezive 200 gr/m2m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*

16. Postera 50x70 me leter adezive 200 gr/m<sup>2</sup> m<sup>2</sup> te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).
17. Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18- Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramatur 620 gr/m<sup>2</sup> që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.
18. Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9- Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramatur 620 gr/m<sup>2</sup> që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.
19. Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37xx26 – Kartoni të jetë 330 gr/m<sup>2</sup>, me 2 krahë, krahët të brendashkruar të palosura 20 cm, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.

**Sasite e parashikuar per secilen kompani per materialete arkives dhe perllogaritja e fondit limit:**

<b>MATERIALE ARKIVE</b>				<b>Viti 2024</b>				
<b>Nr</b>	<b>Pershkrimi i materialit</b>	<b>Njesia</b>	<b>Çmimi</b>	<b>OSSH</b>	<b>OSHEE</b>	<b>FSHU</b>	<b>Total</b>	<b>Vlera</b>
				<b>Sasia</b>			<b>Sasia</b>	
1	Kuti kartoni (40x28x18 )	cope		5,000	70,000	4,500	79,500	
2	Dosje te shtypura me Format 50x70, permasa 37x26	cope		1,200	30,000	500	31,700	

3	<i>Dosje te shtypura me Format 50x70, permasa 33x25.5</i>	<i>cope</i>		1,200	15,000	500	16,700	
4	<i>Dosje te shtypura me Format 50x70, permasa 22x32</i>	<i>cope</i>		1,200	15,000	500	16,700	
5	<i>Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve</i>	<i>cope</i>		1,000	1,000	1,000	3,000	
6	<i>Regjister dhenie- marrje dokumentash</i>	<i>cope</i>		100	1,500	50	1,650	
7	<i>Etiketa per kuti per arkiven qendrore</i>	<i>cope</i>		0	1,000	0	1,000	
8	<i>Etiketa per kuti per arkivat e rretheve</i>	<i>cope</i>		1,000	0	0	1,000	
9	<i>Formular dorezim materialesh ne arkive</i>	<i>cope</i>		50	500	50	600	
10	<i>Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave</i>	<i>cope</i>		150	1,000	100	1,250	
11	<i>Fletehyrje e perkohshme ne arkive</i>	<i>cope</i>		100	500	100	700	
12	<i>Kuti me lidhese me karton</i>	<i>cope</i>		1,200	10,000	500	11,700	
13	<i>Fletepalosje A4</i>	<i>cope</i>		0	1,000	0	1,000	
14	<i>Fletepalosje 20x21</i>	<i>cope</i>		0	1,000	0	1,000	
15	<i>Postera 40x58</i>	<i>cope</i>		0	500	0	500	
16	<i>Postera 50x70</i>	<i>cope</i>		0	500	0	500	
17	<i>Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18</i>	<i>cope</i>		0	50	0	50	
18	<i>Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9</i>	<i>cope</i>		0	50	0	50	
19	<i>Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26</i>	<i>cope</i>		0	50	0	50	

								<b>Totali</b>	<b>22,729,430</b>
--	--	--	--	--	--	--	--	---------------	-------------------

**\*Afatet e lëvrimit: 45 dite nga data e nënshkrimit të kontrates.**

**ADRESAT KU DO TE LEVROHET MALLI: Magazina Qendrore e OSHEE Group Tirane.**

III.4.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.4.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.4.4. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

*“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose*



produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar*

*karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t'u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimi, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t'i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “*specifikim teknik*” nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të parashirojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së

prokurimit përfshirë edhe specififikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ligji 162/2020 "Për prokurimin publik" është përafuar pjesërisht edhe me *Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike", e ndryshuar*". Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar". Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit)*, interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

III.4.6. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh" të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, si dhe të kërkojë që produktet objekt-prokurimi të jenë të cilësisë maksimale. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të tenderit, me pretendimin që të modifikohen/ndryshohen specififikimet teknike në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, dhe të përcaktohen një marzh (+/- 5%) Për sa i përket përmasave të kërkuara dhe peshës së kërkuar, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konkretisht shtojcës 5 "Formulari i specifikimeve teknike", konstaton, se autoriteti kontraktor ka referuar përmasa fikse, pa përcaktuar një diapazon i cili mund të jetë i pranueshëm dhe nuk cenon, për ato artikuj për të cilat nuk është përcaktuar fjala "ekuivalente" apo janë përcaktuar përmasa fikse,. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti

kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë specifikimet teknike, në mënyrë të tillë që mos të sjellin kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentesh, me qëllim përfitimin e një malli apo shërbimi me performancë të lartë e me çmim të ulët. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetit kontraktor nuk duhet të vendosë ato specifikime teknike për realizimin e shërbimit objekt - prokurimi, të cilat bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në çdo rast specifikimet teknike duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e specifikimeve teknike joproporcionale dhe të pajustificuara shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Komisioni gjykon, se për artikujt për të cilët nuk ka një standard kombëtar apo ndërkombëtar në të cilin është mbështetur autoriteti kontraktor, nuk duhet të kufizohemi tek përmasa fikse, për sa kohë funksionaliteti është i njëjtë. Autoriteti kontraktor duhet të rishikojë specifikimet teknike të mësipërme, për sa i përket kontestimeve të ngritura nga ana e operatorit ekonomik ankimes dhe të marrë masa për modifikimin e specifikimeve kufizuese dhe përcaktuese, duke hapur diapazonin, por pa cenuar nivelin minimal të specifikimeve të kërkuara, ashtu sikurse parashikohet edhe në LPP, në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron pjesërisht.

III.5 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Infosoft Office” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderti me arsyetimin se: *“Sikurse e cituam edhe më lart, procedura e prokurimit objekt I këtij ankimi, është pjesë e procedurës së prokurimit me objekt: i Shtypshkrime dhe materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a e ndarë në dy lote, ku Loti i parë është me objekt: Shtypshkrime për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave dhe në të cilin janë përfshirë shtrypshkrime si: regjistra, libra, procesverbale, kartela, libreza, blloqe të ndryshëm, ndërsa në Lotin e dytë me objekt: Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave janë përfshirë gjithshu artikuj të cilët janë shtypshkrime si artikujt me numrat rendore si më poshtë: 5 (Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve); 6 (Regjister dhenie- marrje dokumentash); 9 (Formular dorezim materialesh ne arkive); 10 (Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave); 11 (Fletehyrje e perkohshme ne arkive);*

13 (Fletepalosje A4); 14 (Fletepalosje 20x21); 15 (Postera 40x58); 16 (Postera 50x70) 17(Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18); 18 (Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9); 19 (Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26). Përfshirja e artikujve të mësipërm në këtë procedurë prokurimi, ndërkohë që AK-ja shypshkrimet i ka përcaktuar në lotin e parë të kësaj procedure vjen në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1 Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, si dhe të kërkojë që produktet objekt - prokurimi të jenë të cilësisë maksimale. Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konkretisht nga shqyrtimi i specifikimeve teknike “Shtojca 5”, “Formulari i specifikimeve teknike”, konstaton se autoriteti kontraktor, ka kërkuar gjithashtu Lotin e dytë me objekt: *Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave janë përfshirë gjithashtu artikuj të cilët janë shtypshkrime si artikujt me numrat rendore si më poshtë: 5 (Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve); 6 (Regjister dhenie- marrje dokumentash); 9 (Formular dorezim materialeve ne arkive); 10 (Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave); 11 (Fletehyrje e perkohshme ne arkive); 13 (Fletepalosje A4); 14 (Fletepalosje 20x21); 15 (Postera 40x58); 16 (Postera 50x70) 17(Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18); 18 (Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9); 19 (Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26).* Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të tenderit me arsyetimin se këto artikuj duhet të jenë pjesë e lotit të parë të procedurës së prokurimit, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik nuk ka arritur që të argumentojë, se si përfshirja e këtyre artikujve në lotin e dytë do të cenonte interesin e ligjshëm të operatorit ekonomik, akoma më tej vlen të ritheksojmë, se autoriteti kontraktor referuar edhe përgjigjes së autoritetit kontraktor protokolluar me nr. 1589/2 prot, datë 21.06.2024 ka theksuar se “Këto artikuj janë të përfshirë ngushtësisht me procesin e arkivimit”, ka argumentuar dhe provuar teknikisht, se specifikimet e hartuara prej tij, nuk e kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe nuk i adresojnë ato vetëm tek një prodhues ashtu sikurse pretendon operatori ekonomik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se përfshirja e këtyre artikujve në lotin e dytë nuk cenon interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të tenderit me arsyetimin se: “...së dyti në lidhje me kërkesën e AK-së për paraqitjen e ISO 16245 ose ekuivalent (për prodhimin e kutive dhe të materialeve të tjera, me bazë celulozë, për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve) (e vlefshme, akredituar nga DPA ose nga organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkojmë heqjen në këtëj kriteri pasi: Kërkesa e AK-së për paraqitjen nga ofertuesi i ISO 16245 ose ekuivalent (për prodhimin e

*kutive dhe të materialeve të tjera, me bazë celulozë, për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve), nuk është e mirëargumentuar nga AK-ja dhe nuk është e lidhur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.6.1 Në dokumentet e tenderit, pika 2.4.1, të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka parashikuar si vijon:

#### **2.4.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:**

*Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme me objekt të njëjtë me objektin e prokurimit si më poshtë:*

- *ISO 9001 ose ekuivalent (për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë) e (vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- *ISO 14001 ose ekuivalent (për Menaxhimin e Ambjentit) e (vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- *ISO 45001 ose ekuivalent (për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në punë) (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*
- *ISO 16245 ose ekuivalent (për prodhimin e kutive dhe të materialeve të tjera, me baze celuloze, për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve) (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).*

III.6.2. Në nenin 77, pika 1 dhe 4, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që*

*operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.6.3. Në nenin 79, pika 1 e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet se: 1. *Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

III. 6.4. Neni 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. *Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

2. *Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:*

*a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;*

*b) efijencës së energjisë;*

*c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.*

3. *Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.*

4. *Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

III.6.5. KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë,



pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.6.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi heqjen e kriterit në lidhje me disponueshmërinë e certifikatave ISO 16245 ose ekuivalent (për prodhimin e kutive dhe të materialeve të tjera, me bazë celulozë, për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve), KPP vëren, se certifikimi sipas ISO 16245 specifikon kërkesat për kutitë, mbulesat e dosjeve dhe mbylljet e tjera të bëra nga materiali celulozë, që do të përdoren për ruajtjen afatgjatë të dokumenteve në letër ose pergamenë. Ky dokument është i zbatueshëm për kutitë e bëra prej kartoni të ngurtë ose të valëzuar dhe për kapakët e skedarëve dhe mbylljet e tjera të bëra prej letre ose kartoni. KPP gjykon, se legjislacioni në fuqi për prokurimin publik, i jep mundësinë autoriteteve kontraktore që të kërkojnë certifikime nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar, në mënyrë që të vërtetojnë se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, por me kushtin që certifikimet e kërkuara të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit si dhe kontratës objekt - prokurimi “mallra”, nuk kemi të bëjmë me veprimtari prodhimi, shërbim, ndaj dhe kërkesa e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e ISO 16245 është e ekzagjeruar dhe nuk i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor për realizimin me sukses të kësaj procedure prokurimi, Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa në lidhje mbi disponueshmërinë e ISO të sipërcituara është e ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim të drejtë me volumin e kontratës, objektin e prokurimit dhe është diskriminuese dhe kufizuese për operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt – ankimi, e si rrjedhojë duhet të hiqet nga dokumentet e procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK qëndron.

III.7 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” për modifikimin e dokumenteve të tenderit me arsyetimin se: “...Në lidhje me kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.4.4 të shtojcës 7 të DT-së me përmbajtjen si më poshtë: “2.4.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) dizajner që të ketë mbaruar shkollën e lartë. Kjo të vërtetohet me diplomën e shkollës së lartë, kontratën e punës si dhe certifikatën përkatëse që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik – dizajnit”, Kërkesa e AK-së që në këtë procedurë prokurimi operatori ekonomik të ketë në stafin e tij një dizajner që të ketë mbaruar shkollën e lartë, vërtetuar me diplomën e shkollës së lartë, kontratën e punës si dhe certifikatën përkatëse që vërteton se punonjësit ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit, është ekzagjeruar jo në proporcion

*me objektin e prokurimit pasi artikujt objekt prokurimi janë artikuj për të cilat OE-të nuk e kanë të domosdoshëm që të ketë në staf një dizajner pasi janë artikuj të thjeshtë, një pjesë e tyre janë të gatshëm në treg.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.7.1 Në dokumentet e tenderit, pika 2.4.2 të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka parashikuar si vijon

2.4.4 *Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) dizajner që të ketë mbaruar shkollën e lartë. Kjo të vërtetohet me diplomën e shkollës së lartë, kontratën e punës si edhe certifikatën përkatëse që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit.*

III.7.2. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*

III.7.3. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt

prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kriteret e vendosura me anë të dokumentacionit të dorëzuar në përputhje dhe me përcaktimet ligjore. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.7.4. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.7.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se autoriteti kontraktor, është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, si dhe të kërkojë që produktet objekt - prokurimi të jenë të cilësisë maksimale. Konkretisht, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, KPP nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konstaton, se autoriteti kontraktor, në pikën 2.4.4 të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, dokumenteve të tenderit të ndryshuar, ka kërkuar shprehimisht: *“Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) dizajner që të ketë mbaruar shkollën e lartë. Kjo të vërtetohet me diplomën e shkollës së lartë, kontratën e punës si edhe certifikatën përkatëse që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit.”*. Referuar procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, autoriteti kontraktor ka sqaruar se, *Duke u nisur nga fakti se të gjithë artikujt e kërkuar kërkojnë një përgatitje paraprake të dizajnit nga një specialist i familjarizuar me kërkesat që një material duhet të ketë që të quhet i gatshëm për shtyp, kërkesa për një specialist designer me diplomë universitare është e nevojshme dhe mbi të gjitha që të jete një person që gjithashtu ka specializim në fushën e grafikës për shkak se pjesa më e madhe e artikujve kanë të bëjnë me përgatitjen e formave për prerje. Standardet nderkombetare të prodhimit në fushën e shtypshkrimeve apo marketingut kërkojnë një punë teper e sakte dhe duhet që personi i cili kryen këto punë të jete një specialist edhe në fushën e pictures dhe në atë të grafikës”*. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes mbi kërkesën e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e 1 (një) dizajner, Komisioni gjykon, se ky kriter i vendosur nga autoriteti kontraktor është kufizues dhe jo në përputhje me objektin e kontratës, pasi objekti i kontratës është materiale arkive, referuar tipit të kontratës “mallra”. Autoriteti kontraktor do të furnizohet me mallra objekt - prokurimi, akoma më tej edhe në rastin kur operatorët ekonomikë mund të jenë vetë prodhues të këtyre mallrave referuar procesverbalit për argumentin e specifikimeve teknike. Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për një dizajner që të ketë mbaruar

shkollën e lartë është një kërkesë e ekzagjeruar, nuk është në proporcion me objektin dhe qëllimin e kontratës. Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është realizimi i shërbimit. Ky shërbim mund të realizohet nga një punonjës i specializuar në profesionin dizajner, në çdo degë ekuivalente që fitohet titulli “dizajner. Autoriteti kontraktor të rishikojë kriterin e veçantë të kualifikimit në mënyrë që të hapet konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.8 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” ankimues për modifikimin e dokumenteve të tenderit me arsyetimin se: *“Në lidhje me kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikës 2.4.5 të shtojcës 7 të DT-së mepërmbajtjen si më poshtë: ?2.4.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: ?Makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me permasa më të mëdha ?Makinë qepse me pe me permasa 35x25 ?Makinë prerje me permasa 80x110 ?Makinë qepese me tel ?Thikë një anëshe Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha. Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesis sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqese kontraten e qirase ose huaperdorjes te lidhur mes paleve, me afat kohezgjatje minimalisht dy muaj vlefshmeri, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesis sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji)...i e kudërshtojme me argumentat si më poshtë:..... Pretendojmë se, mënyra se si AK apo të gjitha grupet e punës që mund të kenë marrë pjesë në hartimin e dokumenteve të tenderit i kanë hartuar ato, sjell si pasojë ngushtimin e konkurrencës dhe rrjedhimisht favorizohen në mënyrë të padrejtë kompanitë caktuara duke dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë t caktuar e në rastin konkret janë operatorët ekonomike të cilët i marrin produktet nga kompanitë prodhuese Brenda dhe jashtë vendit dhe më pas i tregëtojnë ato Pse themi se, ky diskriminim dhe përjashtim nga pjesmarrja në këtë procedurë prokurimi është i padrejtë dhe vjen në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Po i argumentojmë edhe njëherë në mënyrë të përmbledhur. Autoriteti kontraktor, për këtë objekt prokurimi ka shpallur procedurën e prokurimit nëpërmjet marrëveshjes kuadër, të kategorisë mall, pra kontratë publike për furnizim Pra, qëllimi i AK-së është të sigurojë, të blejë një mall të gatshëm që në rastin konkret janë kuti dhe dosje, etiketa, shtypshkrime etj.. Mallrat objekt prokurimi mund të sigurohen direkt nga prodhuesit e tyre por mund të sigurohen edhe nga shoqëritë tregëtare të cilat nuk janë vetë prodhuese të tyre por, bashkëpunojnë me kompani prodhuese vendase ose të huaja.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.8.1 Në dokumentet e tenderit, pika 2.4.2 të shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” autoriteti kontraktor ka parashikuar si vijon:

**2.4.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:**

- **Makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me përmasa më të mëdha**
  - **Makinë qepse me pe me përmasa 35x25**
  - **Makinë prerje me përmasa 80x110**
  - **Makinë qepese me tel**
  - **Thikë një anëshe**
- **Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.**
- **Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjetër të fitimit të pronësive sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjetër disponimi të njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqesin kontratën e qirase ose huapërdorjes të lidhur mes paleve, me afat kohezgjatje minimalisht dy muaj vlefshmeri, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjetër të fitimit të pronësive sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjetër disponimi të njohur nga ligji).**

**Per te permbushur kriterin e mesiperme ne fazen e ofertimit, operatori ekonomik duhet deklaronte disponimin e makinave ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces perkatese te DST.**

**Sqarim :** Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

III.8.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;  
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;  
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;  
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;  
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”  
Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.8.2. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.8.3. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 i LPP-së, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që*

*operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.8.4. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim

është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP, i cili parashikon shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.8.5. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka kërkuar: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me përmasa më të mëdha, Makinë qepse me pe me përmasa 35x25, Makinë prerje me përmasa 80x110, Makinë qepëse me tel, Thikë njëanëshe, ndërkohë në procesverbalin ”Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor ka argumentuar”: *Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Kerkohen keto pajisje me qëllim prodhimin e shtypshkrimeve të cilat parashikohen të prodhohen nepermjet linjes teknologjike prodhuese. Të gjitha llojet dhe formatet e makinerive dhe pajisjeve të kerkuara janë në përputhje të plote me kërkesat dhe specifikimet teknike të mallrave/shtypshkrimeve që kerkohen të furnizohen”. Nisur nga objekti i prokurimit “Materiale arkive për nevoja të OSHEE Group SHA dhe bijave”, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, si dhe referuar llojit të kontratës së procedurës së prokurimit ”mallra” Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor është e nevojshme që nëpërmjet kriterëve të veçanta të kualifikimit të sigurohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë kapacitetet teknike për kryerjen me sukses të furnizimit objekt i prokurimit, konkretisht realizimit të produktit final dhe furnizimit me këtë të fundit. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme përmbushja me sukses e kontratës objekt - prokurimi, furnizimi me mallra sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Akoma më tej, referuar objektit të kontratës dhe nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë, mund të jenë*



vetë prodhues të mallrave objekt - prokurimi, por mund dhe të sigurojnë mallrat objekt - prokurimi nga operatorë ekonomikë të cilët nuk janë vetë prodhues të këtyrë mallrave.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë dhe të modifikojë kriterin e veçantë të kualifikimit sipas konstatimeve të mësipërme, duke hapur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë të interesuar, për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-07760-06-03-2024, me objekt: “**Loti i dytë: ‘Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group SHA dhe bijave’** me vlerë fondi limit **22,729,430 (njëzet e dy milion e shtatëqind njëzet e nëntë mijë e katërqind tridhjetë)** lekë pa TVSH ose 225,356.2 (dyqind e njëzet e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë dy) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 04.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group SHA.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës, të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK.
  6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK.
  7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

